



INSTITUTI I SHENDETIT PUBLIK

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE

(Pasqyra 14/Sh)

QERSHOR 2019

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimit të Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14/Sh. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14/Sh për muajin qershor 2019 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në rrethe.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit qershor 2019 zënë 38.04 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14/Sh, dhe paraqesin një incidencë 215.9/100.000 banorë. Dihet që periudha e muajve të nxehtë të vitit mbart me vete frekuencën më të lartë të episodeve diarreike, ku në muajin qershor vihet re një tendencë në rritje e sëmundjeve diarreike. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që në nivel kombëtar, helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 5.96/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Kukës dhe Kavajë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rrethëve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Gjatë muajit qershor 2019 janë raportuar 23 raste të konfirmuara me Salmonelozë jotifoide nga NJVKSH-të, përkatësisht 13 raste nga rrethi i Dibrës, 7 raste nga rrethi i Shkodrës, 2 raste të raportuara nga Tirana dhe një rast nga rrethi i Vlorës. Rastet janë konfirmuar nga laboratorët mikrobiologjikë të NJVKSH-ve të rrethëve përkatëse. Rastet janë nga njësi administrative të ndryshme, janë sporadike dhe nuk kanë lidhje epidemiologjike me njëra-tjetrën.

Rrethi i Shkodrës vazhdon të mbajë peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës jotifoide për muajin qershor 2019 me 22 raste (1.32/10.000 banorë) të konfirmuara në laboratorin mikrobiologjik të NJVKSH-së Shkodër, që u përkasin grup-moshave të ndryshme.

Gjatë muajit qershor është raportuar nga rrethi i Tiranës një rast me diagnozë Tifo abdominale, mashkull i grup-moshës 30-34 vjeç, i shtruar dhe konfirmuar në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT), Shërbimi i Infektivit. NJVKSH-ja Tiranë ka marrë masat përkatëse.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidenat e sëmundjeve diarreike për muajin qershor 2019
(Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste qershor 2019	Incidenca qershor 2019 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	1	0.04
Salmonelozë	23	0.82
Shigelozë (Disenteri bacilare)	22	0.79
Dizenteri amebike	0	0
Helmime ushqimore	167	5.96
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	6048	215.9
Sëmundje diarreike në total	6261	223.60

2. Sëmundjet e parandalueshme nga vaksinat (EPI)


2.1. Fruthi

Gjatë muajit qershor 2019, në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit, janë dyshuar në total 36 raste prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv 18 raste. Nga këto 5 raste (28%) e rasteve i përkasin rrethit të Tiranës dhe 4 raste (22%) rrethit të Lushnjës, 3 raste (17%) rrethit të Korçës. Rrethet e Durrësit, Gjirokastrës, Kavajës, Kukësit, Lezhës dhe Pogradecit kanë patur nga 1 rast të konfirmuar me fruth.

28% e rasteve të konfirmuara i përkasin kryesisht grup-moshës < 2 vjeç dhe 2-4 vjeç (5 raste secila). Rastet e tjera janë të shpërndara në grup-moshat e të rriturve. Gjatë muajit qershor vërehet një rënie e rasteve me fruth. Një informacion më të zgjeruar mund ta gjeni në “Buletinin Javor të Fruthit”, në faqen elektronike zyrtare të ISHP-së.



Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rash-it, qershor 2019



Grafiku 2. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rash-it, qershor 2018

Në muajin qershor të vitit 2018 u raportuan në total 217 raste, prej të cilave 126 u konfirmuan nga ana laboratorike. Nga këto, 68 raste ose 54% i përkisnin rrethit të Tiranës. 19.8% ose 25 raste i përkisnin grup-moshës 16-20 vjeç dhe 19% ose 24 raste grup-moshës nën 2 vjeç.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, numri i rasteve është në rënie dhe mosha pediatrike vazhdon të jetë më e prekur. Kjo për shkak edhe të mosvaksinimit, kontaktit apo vizitës së mëparshme në shërbimin pediatrik QSUT.

Të gjitha rastet janë konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë, në ISHP.

2.2. Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit qershor 2019 janë raportuar 30 raste me tuberkuloz pulmonar dhe ekstrapulmonar. Rastet e raportuara me tuberkuloz pulmonar janë në total 27, përkatësisht nga Tirana (12 raste) dhe Lushnja (3 raste). Bulqiza, Elbasani, Mirdita dhe Shkodra kanë raportuar përkatësisht nga 2 raste, dhe nga 1 rast kanë raportuar Vlora, Berati, Durrësi dhe Puka. Rastet i përkasin grup-moshave të ndryshme.

3. Zoonozat

Gjatë muajit qershor 2019 me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS), të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14/Sh, janë raportuar nga NJVKSH-të në nivel vendi tri raste me brucelozë, nga të cilat dy raste janë të konfirmuara. Rastet janë raportuar nga rrethet Fier, Gjirokastër dhe Lushnjë dhe i përkasin grup-moshës 40-59 vjeç.

Gjatë muajit qershor 2019 janë raportuar tri raste të konfirmuara me antraks nga NJVKSH-ja Sarandë.

Një rast i dyshuar me Leptospirozë është raportuar nga NJVKSH-ja Fier, mashkull i grup-moshës 30-34 vjeç.

Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike në qershor 2019

(Incidenca raste/100.000 banorë)	Raste qershor 2019	Incidenca qershor 2019 (raste/100.000 banorë)
Antraks (Plasje)	3	0.11
Brucelozë	3	0.11
Leptospirozë	1	0.04
Leishmaniazë viscerale	0	0
Leishmaniazë kutane	0	0

4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit qershor 2019 janë raportuar në total 25 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.89/100.000 banorë), nga të cilat 5 raste janë hepatite virale të paspecifikuara, 20 raste Hepatite Virale B (HBV) të konfirmuara në laboratorët e NJVKSH-ve në rrethe.

Në lidhje me HBV-në, 20 rastet e konfirmuara janë raportuar përkatësisht nga rrethi Tiranë (0.29/10.000 banorë), Fier (0.06/10.000 banorë) dhe Mat (0.22/10.000 banorë). Rastet me Hepatit Viral B i përkasin grup-moshës së rritur.

5. HIV/AIDS

Në muajin qershor 2019 janë kryer në total 36 ekzaminime për HIV, 23 meshkuj dhe 13 femra. Nga këto ekzaminime, 11 prej tyre kanë rezultuar pozitive (9 meshkuj dhe 2 femra). Rastet pozitive i përkasin grup-moshave si më poshtë: nga 2 raste grup-moshat përkatësisht 16-24 vjeç dhe 25-29 vjeç, 2 raste grup-mosha 40-44 vjeç, 1 rast përkatësisht grup-mosha 30-34 vjeç, 35-39 vjeç, 55-59 vjeç, grup-mosha 65+vjeç. Për një rast mungon kjo e dhënë. Shpërndarja sipas rretheve tregon se 5 raste i përkasin rrethit Tiranë, 3 raste rrethit Elbasan, 1 rast kanë rrethet Shkodër, Përmet dhe Sarandë.

Mostrat e gjakut që kanë rezultuar pozitivë kanë ardhur në ISHP si më poshtë: 3 raste nga klinikat (dy nga Infektivi dhe një nga Sanatoriumi), 2 raste janë ndjekje epidemiologjike pas diagnozës së njërit prej partnerëve, 2 nga Qendrat e Testimit Vullnetar (VCT) Tiranë, 2 nga VCT-ja Elbasan, 1 rast nga Banka Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut (BKTGJ).

INSTITUTI I
SHËNDETIT PUBLIK

DEKSI